



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Kryetari i Komunës
01.Nr. 115/C2 - 8998 2020
Kaçanik, 03.04.2020

Në bazë të nenit 90 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 35 pika 8 dhe 9 e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, merr këtë :

VENDIM **Për përfundimin e marrëdhënies së punës**

1. Nënpunësit civil z. Hafet Ceka i caktuar me punë detyra të punës, Drejtor në SHFMU "Gafurr Luma" në Gllloboçicë, në kuadër të Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, i përfundon marrëdhënia e punës në këtë detyrë, me arrijtjen e moshës së pensionimit më **05.04.2020**.
2. I lartpërmenduri gëzon të drejtën e marrjes së tri paga përcjellëse, sipas mesatares së tri pagave të fundit, si dhe përfiton shpërblim jubilar 150% të një page bazë.

A r s y e t i m

z.Hafet Ceka, Drejtor në SHFMU "Gafurr Luma" në Gllloboçicë, në kuadër të Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, më 05.04.2020, arrin moshën e pensionit. Spas nenit 90 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kur i punësuari e mbush moshën e pensionit, prej gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç, i përfundon marrëdhënia e punës. Gjithashtu, bazuar edhe nenit 35 pika 8 dhe 9 e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, i lartpërmenduri gëzon të drejtën e marrjes së tri paga përcjellëse, sipas mesatares së tri pagave të fundit, si dhe përfiton shpërblim jubilar 150% të një page bazë. Kryetari i Komunës, në pajtim me Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për përfundimin e marrëdhënies së punës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike : Kundër këtij vendimi pala e paknaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes, Komisionit për Ankesa në Komunën e Kaçanikut.

Me këtë vendim njoftohen: z. Hafet Ceka, Drejtoria e shkollës përkatëse, Drejtoria për Ekonomi Financa dhe Zhvillim dhe Arkiva.

Kryetari i Komunës
z. Besim Ilazi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Kryetari i Komunës
01.Nr. 113/01-8999 /2020
Kaçanik, 03.04.2020

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 si dhe neni 9 pika 3 e Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr. 15/2019, për Detyrat, Përgjegjësitë, Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe zv. Drejtorit të Institucionit Publik Edukativo- Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. z. Hafet Ceka, i vazhdohet marrëdhënia e punës, Drejtor në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët "Gafurr Luma" në Gllloboçicë..
2. Të lartshënuarit, kohëzgjatja e marrëdhënies së punës, do ti vazhdohet nga data 01.04.2020 deri 05.04.2020, sipas akteve normative në fuqi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset : Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes.

Arsyetim

Pas skadimit të kontratës 04.Nr.112-4236/16 të z. Hafet Ceka, drejtor në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët "Gafurr Luma" në Gllloboçicë, në përputhje me Udhëzimin Administrativ të MASHT-it Nr. 15/2019, për detyrat, përgjegjësitë, procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së Drejtorit dhe zv. Drejtorit të Institucionit Publik Edukativo- Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar, përkatësisht neni 9 pika 3, të këtij udhëzimi, nga punëdhënësi, janë bërë vlerësimet pozitive të performacës, në institucionin që e ka menaxhuar, prandaj edhe është vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtën e ankesës në afat prej 30 ditësh prej ditës së pranimit të këtij vendimi në komisionin për zgjedhjen e ankesave dhe kontesteve.

Me këtë vendim njoftohen: z.Hafet Ceka, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës dhe Arkiva.

Kryetari i Komunës
z.Besim Ilazi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

Zyra e Kryetarit

Në bazë të Vendimit të Kuvendit Komunal të dates 26.03.2020 - **01Nr.400/01-8928/20** per Ndarjen e mjeteve financiare per menaxhimin e situates emergjente te krijuar nga pandemia Covid-19, Procesverbalit nga mbledhja e Shtabit Komunal i themeluar per parandalimin e Covid 19 te dates 07.04.2020, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

Neni 1.

Me anë të këtij vendimi i lejohej gjithë Administraorëve të fshatrave dhe pjesës urbane të komunes se Kaçanikut, që për qëllime të angazhimit të tyre në drejtim të përkrahjes së banorëve të komunes për përballimin e pandemisë Covid-19, të furnizohen me derivate-naftë deri në 50 litra për secilin Administratorë.

Neni 2.

Për sasinë e lejuar sipas pikes 1. të këtij vendimi, përfituesit e lartëcekur mund të furnizohen me derivate të naftës tek operatori ekonomik, i cili ka kontratë të arritur me K.Kaçanik për furnizim me derivate “Bubeari Petrol”.

Neni 3.

Administratoret e shënuar në listen e bashkëngjitur të këtij vendimi, obligohen që me rastin e furnizimit me derivate paraprakisht të prezantojnë ID.e tyre personale dhe nënshkruajnë pranë OE - “Bubeari Petrol” si argument për realizimin e këtij qëllimi.

Neni 4.

Me këtë vendim njoftohen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Financave dhe OE “Bubeari Petrol”

Bashkëngjitur këtij vendimi:

- Lista e Administratorëve (Përfaqësuesve të vendbanimeve) të Komunës së Kaçanikut.




KOMUNA E KAÇANIKUT

Besim Ilazi, Kryetar i komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

01Nr. 400/01-2134/20

Në bazë të Ligjit 07/L-001 Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, rregullores Nr. Nr.06/2016 nenit 4 paragrafi 1 dhe 2, nenit 7 dhe nenit 8 pika 5, 7, 9 dhe nenit 19, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e ndarjes së subvencioneve, në mbështetje të fermerëve, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

PËR LEJIMIN E MJETEVE FINANCIARE

1. Me këtë Vendim lejohet ndarja e mjeteve në shumë prej 55,000.00 €, për furnizimin e fermerëve përfitues të projektit të serrave (171), me qëllim të realizimit të projektit “Mbështetje e fermerëve me serra me sipërfaqe prej 50m²”.
2. Fermerët përfitues obligohen që të participojnë 20% të vlerës së serrës, në llogarinë rrjedhëse të Komunës.
3. Mbështetja financiare publike për projektet /programet e drejtorisë BZHRP-së, do të ofrohet nga Buxheti i Komunës, subvencione dhe transfere me buxhetin e ndarë për vitin 2020
4. Mjetet e përmendura në nenin 1 dhe 2 do të transferohen në llogarinë rrjedhëse të kompanisë fituese të tenderit, pas përfundimit të ndërtimit të serrave (171), në bazë thirrjes publike për realizimin e projektit të Drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë.
5. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është: Drejtoria e Financave, Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë
6. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit

Kryetari i Komunës

Besim Ilazi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Zyra e Kryetarit

01Nr. 104/02 - **9335** /2020
Kaçanik 29.04.2020

Në mbështetje të **Ligjit 04/- L-27** të nenit 54 paragrafi 2 pika 2.3 dhe paragrafi 3 dhe 4, neni 55 paragrafi 3, Rregullores së QRK –Nr.18/2013 për Organizimin dhe Operimin e Sistemit të Monitorimit, Njoftimit dhe Paralajmërimit, Sistemin e Integruar të Menaxhimit Emergjent si dhe nenit 10 të statutit të komunës së Kaçanikut nxjerrë këtë :

V E N D I M

I. Për aktivizimin e Qendrës Operative Emergjente Lokale me rastin e shfaqjes së pandemisë të virusit COVID 19 në përbërje :

- Bujar Bajra - zyrtar i Alarmimit dhe Koordinimit Emergjent
- Naim Hysa - Sekretar i Kryqit të Kuq
- Besnik Bajra - Inspektor Sanitar

II. Qendra Operative Emergjente Lokale grumbullon dhe përcjellë të dhënat për fatkeqësitë natyrore si dhe fatkeqësitë tjera, që kanë të bëjnë me masat preventive para këtyre dukurive ,të gjitha këto ia përcjellin shtabit emergjent komunal dhe QOE regjionale.

- Bëjnë informimin e organeve kompetente si dhe personave përgjegjës për masat e sigurisë në organizata të ndryshme,
- U japin informacion organeve dhe personave përkatës komunal, dhe shtabit emergjent komunal
- Ofrojnë mbështetje komunikimi dhe informimi për shtabin emergjent komunal
- Zhvillojnë aktivitete tjera në bazë të urdhrave të shtabit emergjent
- Aktivizojnë dhe i koordinojnë aktivitetet e njësiteve komunale si dhe strukturave tjera
- I sigurojnë mundësitë komunikative dhe informative si dhe ndihma tjera shtabit emergjent në Komunë.

III. Drejtoria e DSHPE-së obligohet që menjëherë të bëjë aktivizimin e QOE-së

IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Besim Ilazi
Kryetar i Komunës



Me këtë vendi njoftohen: z. Ramadush Osmani Drejtor i DSHPE-së, zyrtarët përgjegjës dhe Arkivi